



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:241083

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05602665

**PKR.nr.5/2022**

**NË EMËR TË POPULLIT**

- **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda**, Trupi Gjykses i përbërë nga Gjyqtarët : Fatos Sejdijaj, Kryetar dhe Fuad Haliti e Leart Rexhaj-anëtarë, me zyrtarin ligjor Bardh Sylejmani-procesmbajtës, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarit H.M.nga Vushtrria, për shkak të veprës penale – Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.182/2020 të datës 18.01.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor me datë 04.04.2024 i cili ka qenë i hapur për publikun, në të cilën kanë prezantuar Prokurorja e Shtetit Fetije Bajrami, i akuzuari H.M.dhe Mbrojtësja e tij, caktuar sipas detyrës zyrtare Av.Nadire Koshi, më datën 04.04.2024 e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa me datë 22.04.2024 e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**- I akuzuari :**

**H.M.**, nga babai ..... dhe nëna ....., mbiemri i vajzërisë ....., i lindur me datë ..... në ....., ku dhe jeton, Rr.”.....” Nr....., me numër personal ....., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, i martuar – baba i katër (4) fëmijëve, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike.

- Në bazë të nenit 363 paragrafi 1, nënpar.1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP) :

**- L I R O H E T N G A A K U Z A -**

- **SEPSE** : Me datën 11.06.2017, në fsh.Maxhunaj-Komuna Vushtrri, në shkollën fillore “.... ”, i pandehuri në cilësinë e kryesuesit të Këshillit të Vendvotimit në Qendrën e Votimit ....., vendvotimi me Nr..... duke e shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare apo autoritetin zyrtar në lidhje me zgjedhjet ka shtuar dhe hequr votat, në atë mënyrë që pas rinumërimit në Qendrën e Numërimit të Rezultateve është bërë

krahasimi i të dhënave ku është identifikuar ndryshimi i votave, ashtu që gjatë numërimit të votave të kandidatëve brenda subjektit politik, ka hequr votat e disa kandidatëve dhe i ka shtuar të disa kandidatëve të tjerë duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë gjithsej 131 vota, ku prej tyre 119 vota të shtuara dhe 12 vota të hequra.

**- Me këtë kishte për të kryer veprën penale-Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur e par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

- Kërkesë pasurore – juridike nuk kishte.

### **- A r s y e t i m -**

**- Rrjedha e çështjes –**

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda në këtë Gjykatë ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.182/2020 me datë 18.01.2022, kundër të akuzuarit H.M.nga Vushtrria, për shkak të veprës penale-Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

- Gjykata në këtë çështje penale më datë 04.04.2024 e ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, e cila ka qenë e hapur për publikun, ndërsa ishin prezent Prokurorja e shtetit Fetije Bajrami, i akuzuari H.M., Mbrojtësja e tij, caktuar sipas detyrës zyrtare Av.Nadire Koshi si dhe dëshmitari S.H..

- Gjykata konform nenit 319 par.2 të KPP-së, të akuzuarin e ka njoftuar me të drejtat e tij procedurale dhe i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij, sa i përket mbrojtjes në këtë çështje penale ka deklaruar se meqë nuk ka mundësi financiare, pajtohet që të mbrohet përmes mbrojtësit të tij, caktuar sipas detyrës zyrtare Av.Nadire Koshi.

- Duke qenë se në këtë çështje penale i akuzuari akuzohej për veprën penale-Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, meqë mbrojtja është e detyruar, me aktvendim procedural Gjykata duke vepruar në përputhje me nenin 56 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, për mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike të akuzuarit i është caktuar Av.Nadire Koshi nga Mitrovica.

**- Fjala përfundimtare e palëve –**

- **Prokurorja e shtetit Fetije Bajrami** përgjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se, mbetet në tërësi pranë aktakuzës ndaj të akuzuarit H.M.për shkak të veprës penale si në aktakuzë, duke shtuar më tej se i akuzuari ka kryer këtë veprë penale e që vërtetohet nga dëgjimi i dëshmitarit dhe administrimi i provave, se pas rinumërimit të votave në QNR është bërë krahasimi i të dhënave të cilat janë krijuar në vendvotim dhe është identifikuar ndryshimi i votave, ku në rastin e numërimit të votave të kandidatëve është vërejtë se brenda një subjekti politik janë hequr votat e disa kandidatëve dhe janë shënuar votat e disa kandidatëve të tjerë duke regjistruar në mënyrë jo të saktë gjithsej 131 vota, prej tyre 119 vota të shtuara dhe 12 vota të hequra, e që kjo vërtetohet nga të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës andaj, i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe t'i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe ta dënojë sipas ligjit.

- **Mbrojtësja e të pandehurit Av.Nadire Koshi** përgjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se, në bazë të administrimit të provave, dëshmisë së dëshmitarit dhe mbrojtjes së të akuzuarit konstatohet se nuk kemi të bëjmë me veprë penale me të cilën i akuzuari ngarkohet, duke konsideruar se gabimet janë bërë për shkak të lodhjes dhe pagjumësisë ngase, i akuzuari është një person i ndershëm dhe bujar dhe të ardhurat e tij i fiton me djersë, se punon me zgjedhje që prej administratës së UNMIK-ut dhe asnjëherë nuk ka pasur gabime të tilla, andaj i propozoi gjykatës që ndaj tij të marrë aktgjykim lirues sepse vepra penale për të cilën akuzohet, nuk përbënë veprë penale.

- **I akuzuari** përgjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare u deklarua i pafajshëm lidhur veprën penale për të cilën akuzohet tutje ka theksuar se, e mbeshtetë fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij ashtu që, i propozojë gjykatës që ta lirojë nga aktakuza.

#### - **Provat e administruara –**

- Gjykata, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike ka dëgjuar dëshmitarin-S.H., si dhe ka administruar provat materiale si në vijim :

- Librin e votimit për vendvotimin Nr.2714B/01R,

- Fromularin (kopje) i Përputhjes së të Dhënave të Rezultateve (FPR) e krijuar në vendvotimi nr.2714B/01R dhe FPR e rinumëruar në QNR (kopje),

- Fromularin (kopje) i Përputhjes së të Dhënave të Rezultateve të Kandidatve (FRK) e krijuar në vendvotimin nr.2714B/01R dhe FRK e rinumëruar në QNR (kopje),

- Tabelën në Excel e specifikuar me emrin e kandidatit, subjektin politik dhe pasqyra e votave të numëruara në vendvotim dhe rezultati pas rinumërimit në QNR (votat të cilat janë shtuar apo hequr).

- Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.04.2024, është dëgjuar dëshmitari S.H. i cili ka deklaruar se në zgjedhjet e vitit 2017 ka punuar si kryesues i tavolinës në Qendrën e numërimit e cila është në kuadër të KQZ-së, dhe se detyrat e tij kanë qenë shikimi i shiritave mbyllës të kutisë në këtë qendër, të cilat vijnë nga qendra e vendvotimeve pastaj futen në linjë në bazë të numrave dhe vendvotimeve, shpërndarësi i kutive i shpërndan kutiat pa ndonjë numër rëndor. Sipas tij, në zgjedhjet qëndrore subjektet politike i dërgojnë komisionerët dhe se mundësia që të ndodhin gabime teknike gjatë rinumërimit është shumë e ulët. Dëshmitari tutje ka deklaruar se përgjegjësia në rast të mospërputhjes së numërimit të votave nga Këshilli i vendvotimit është përgjegjësi dyshe, në kuptim të asaj se është numëruesi dhe verifikuesi, por që më shumë i njëjti deklaroi se këtë nuk e di pasi që më shumë përvojë ka në QNR.

- Gjykata në këtë çështje penale nuk e ka dëgjuar në cilësinë e dëshmitares K.M., zyrtare në Komisionin Qendror Zgjedhor në Prishtinë pasi që, Prokuroria e shtetit në shqyrtimin gjyqësor të datës 04.04.2024 ka hequr dorë nga dëgjimi i saj.

- Pas administrimit të provave, i akuzuari u njoftua me të drejtat e tij nga neni 319 par.2 i KPP-së, në cilësinë e palës së akuzuar në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 04.04.2024, dhe i njëjti deklaroi se ka qenë kryesues i vendvotimit në zgjedhjet Qendrore në fshatin Maxhunaj në vitin 2017. Sipas tij ditën e zgjedhjeve ka punuar së bashku me shtatë komisionerë të tjerë, ndërsa në ditën e votimit si kryesues në ora 03:00 të mëngjesit kishte marr materialin dhe përgatitur procesin e vendvotimit. Ndërsa në pyetjen e avokatës mbrojtëse se : “a ka qenë në dijeni se ka pasur 131 vota jo të sakta” i pandehuri është përgjigjur se “jo”, dhe nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi gjatë votimit, dhe se pas përfundimit të votimit me rastin e rinumërimit të fletëvotimeve nuk ka pasur ndonjë parregullsi që është shënuar as nga ai vet si kryesues e as nga anëtarët e tjerë. Sipas të akuzuarit, para procesit të numërimit të fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve, procedura fillon me formimin e tavolinës në formë të shkronjës “T”, aty kryesuesi largohet dhe merr pozitën e tij në vendin e caktuar që i takon, i njëjti i cakton dy komisioner për numërim të votave të kandidatëve dhe një e cakton si verifikues i cili i verifikon-shënon numrin e votave të kandidatëve në flliko, pas përfundimit të gjithë këtij numërimi të votave të të gjithë kandidatëve, njëri nga komisionerët e ka për detyrë ta informoj kryesuesin për secilin numër të kandidatëve përkatës se secili veç e veç sa vota i ka pasur, pastaj kryesuesi numrat-rezultatet e kandidatëve të marra i evidenton në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve, ata i diktojnë ndërsa kryesuesi i evidenton, pastaj mbyllet kutia e më pas ngjiten shiritat mbyllës dhe dërgohen në KKZ- Komisionin Komunal Zgjedhor. Në pyetjen e prokurorit të shtetit se: “a i keni shikuar të dhënat e marra nga komisionerët se a janë të sakta dhe a përputhen?” i akuzuari është përgjigjur tekstualisht :

*“jo për shkak se është përgjegjësi e tyre nga se ata mi kanë dhënë mua ndërsa unë i kam shënuar në formularin përkatës”.*

**- Vlerësimi i gjykatës –**

- Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve, dëgjimit të dëshmitarit dhe administrimit të provave materiale të lartë cekura, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku në përputhje me nenin 360 të KPP-së, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë të kësaj çështje penale, kjo Gjykatë vlerëson se në veprimet e të akuzuarit nuk manifestohen asnjë nga elementet objektive dhe subjektive të veprës penale-Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 219 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

- Nuk është kontestues fakti se më datë 11.06.2017 janë mbajtur Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në tërë territorin e Republikës së Kosovës, e në mesin e vendvotimeve të hapura është edhe Vendvotimi Nr..... në fshatin Maxhunaj, komuna e Vushtrrisë.

- Nuk është kontestues fakti që i akuzuari H.M. ka qenë kryesues i Këshilli të Vendvotimit Nr..... në shkollën fillore “.....” në fshatin ....., komuna e Vushtrrisë, fakt i cili nuk është kontestuar nga i akuzuari në asnjë fazë të procedurës, por që vërtetohet edhe nga provat e administruara.

- Nuk është kontestuese se në këtë vendvotim, sipas procedurës, pas përfundimit të orarit të votimit, ishin numëruar votat, ashtu që fillimisht ishin numëruar votat për subjektet politike, e pastaj votat për kandidatët. Këto rezultate ishin pasqyruar në FPR dhe në FRK.

- Nuk është kontestues as fakti se për rezultatet e këtij vendvotimi ishte urdhëruar rinumërimi i votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), në Prishtinë. Po ashtu, nuk është kontestues as fakti se kishte mospërputhje të rezultateve të kandidatëve në mes votave të numëruara në Vendvotimin Nr..... , dhe atyre të numëruar në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, në Prishtinë.

- Në lidhje me këtë, Gjykata e merr si të vërtetuar faktin se nga rinumërimi i kryer, kishte mospërputhje të rezultateve të kandidatëve, ashtu që në tërësi rezultonin njëqind e tridhjetë e një (131) vota jo të sakta, prej tyre njëqind e nëntëmbëdhjetë (119) vota të shtuara për kandidatët e subjekteve të ndryshme politike, ndërsa dymbëdhjetë (12) vota të hequra për kandidatët e subjekteve të ndryshme politike.

Ky fakt, përveç që nuk është kontestuar nga i akuzuari, vërtetohet edhe nga provat e administruara, respektivisht nga FPR në rinumërim, ku pas rinumërimit ka rezultuar se disa kandidatëve u janë shtuar vota e disave u janë hequr votat.

- Gjykata vëren se kryesisht votat e shtuara dhe hequra variojnë dhe atë, të shtuara për subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës+Kualicioni gjithsej njëzetë e tre (23) vota, Lidhja Demokratike e Kosovës shatëdhjetë e katër (74) vota të shtuara, dhe Lëvizja Vetëvendosje gjithsej njëzetë e dy (22) vota të shtuara. Ndërsa, të hequra rezultojnë pesë (5) vota për Partinë Demokratike të Kosovës+Kualicioni, dy (2) vota për Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe pesë (5) vota për Lëvizjen Vetëvendosje. Pra, Gjykata konstaton se shtimi dhe heqja e votave është bërë vetëm për votat e kandidatëve të subjekteve të ndryshme politike, derisa votat për subjektet politike, edhe pas rinumërimit kanë rezultuar të sakta, sikurse janë numëruar në Vendvotimin Nr.2714B/01R.

- Mbi bazën e këtyre fakteve të lartcekura, kontestuese në këtë çështje penale ishte fakti se kush i ka shtuar dhe hequr këto vota të kandidatëve, respektivisht a i ka ndërmarrë këto veprime i akuzuari H.M., si kryesues i Vendvotimit Nr..... në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 11.06.2017.

Gjykata vëren së prokuroria në aktakuzën e saj pretendon se i akuzuari H.M., duke qenë kryesues i Këshillit të Vendvotimit Nr. .... , duke përdorur pozitën e tij zyrtare ose autorizimin zyrtar lidhur me zgjedhje, ka shtuar dhe hequr votat e disa kandidatëve të subjekteve të ndryshme politike, të cilat nuk i përgjigjen rezultateve të vërteta, duke regjistruar në mënyrë jo të saktë 131 vota të kandidatëve, të subjekteve të ndryshme politike, ku prej tyre 119 vota të shtuara dhe 12 vota të hequra.

Nga administrimi i provave, Gjykata nuk ka arrit të vërtetojë se i akuzuari i ka shtuar dhe hequr votat e ndonjë kandidati të ndonjë subjekti, respektivisht se i ka falsifikuar rezultatet, sipas numrit të pretenduar nga prokuroria prej 131 vota. Me asnjë nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësorë nuk mund të vërtetohet se i akuzuari, me dashje, si kryesues i ka falsifikuar votat e kandidatëve, apo sipas shprehjes së prokurorisë i ka shtuar dhe hequr votat.

- Nga dëshmia e dëshmitarit S.H., Gjykata vërtetoi faktin se gjatë numërimit të votave marrin pjesë shumë persona dhe jo vetëm kryesuesi, sipas këtij dëshmitari përgjegjësia me rastin e numërimit të votave është dyshe, në kuptim të asaj se gjatë numërimit të votave është numëruesi dhe verifikuesi, pra një person i numëron votat dhe të njëjtat verifikohen edhe nga një kryesues në rolin e verifikuesit.

- Nga libri i vendvotimit ..... i datës 11.06.2017, Gjykata e vërtetoi faktin se e gjithë rrjedha e procesit të zgjedhjeve është evidentuar në këtë regjistër dhe nuk është theksuar asnjë parregullsi gjatë procesit të zgjedhjeve.

- Nga formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve (FPR) e krijuar në vendvotimin Nr.2714/1R dhe FPR rinumëruar në QNR, Gjykata vërtetoi faktin se gjatë rinumërimit janë hasur mospërputhje mes votave dhe atë vota të shtuara dhe vota të hequra mes kandidatëve të subjekteve politike.

- Si dhe nga tabela (Exel) e specifikuar me emrin e kandidatit, subjektin politik, dhe pasqyra e votave të numëruara në vendvotimin dhe rezultati pas rinumërimit në QNR (votat të cilat janë hequr apo shtuar), Gjykata vërtetoi faktin se në këtë tabelë janë specifikuar të gjitha votat e shtuara dhe atë 119 vota të shtuara dhe 12 vota të hequra.

- Gjykata ka pranuar mbrojtjen e të pandehurit dhënë në fazën fillestare të hetimeve me datë 27.10.2021 në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda si dhe në shqyrtimin gjyqësor të datës 04.04.2024 se, në ditën e zgjedhjeve ka qenë në cilësinë e kryesuesit dhe ka punuar së bashku me shtatë komisionerë në vendvotimin Nr..... në Zgjedhjet e datës 11.06.2017, dhe se i njëjti nuk ka pasur dijeni për parregullsitë gjatë numërimit të votave, Gjykata pranoi mbrojtjen e të pandehurit dhe mënyrën se si i njëjti e kishte sqaruar gjithë rrjedhën e numërimit të votave gjatë ditës së zgjedhjeve. Mbrojtja e tij gjenë mbështetje në dëshminë e dëshmitarit që është dëgjuar në shqyrtim gjyqësor si dhe në provat tjera materiale që janë administruar nga ana e gjykatës. Ndërsa, Gjykata vlerëson se nuk ka prova të tjera të cilat do e vënin në dilemë mbrojtjen e dhënë nga i akuzuari.

Gjykata vëren se është e pakontestueshme se, sikurse FPR-në, ashtu edhe FRK, në Vendvotimin Nr....., i kishte plotësuar kryesuesi i këtij Vendvotimi, pra i akuzuari. Megjithatë, vetëm nga fakti se i ka plotësuar këto formular, nuk mund të nxjerrët konstatimi se ai i ka falsifikuar këto rezultate, më konkretisht se i ka shtuar dhe fshirë votat për disa kandidatë nga subjekte të ndryshme politike.

Prandaj, në këtë drejtim, për të mundur Gjykata të vërtetojë nëse i akuzuari i ka falsifikuar këto rezultate, duhet t'i referohet procedurës së parashikuar për numërimin dhe plotësimin e formularëve me rastin e numërimit të votave.

Prandaj, duke qenë i akuzuari kryesues i Këshillit të Vendvotimi Nr. 2714B/01R, ai edhe kishte detyra të caktuara, si gjatë zhvillimit të zgjedhjeve, ashtu edhe me rastin e numërimit të rezultateve. Në këtë drejtim, për të vlerësuar nëse i akuzuari i ka kryer detyrat e tij, fillimisht Gjykata duhet t'iu referohet se cilat kanë qenë detyrat dhe përgjegjësit e kryesuesit të vendvotimi, specifikisht, detyrat dhe përgjegjësitë me rastin e numërimit të rezultateve të votimit.

Kështu, neni 102, par. 2, i Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (tutje:Ligji për Zgjedhjet), në atë kohë në fuqi, ka përcaktuar: *“Kryesuesi i komisionit të vendvotimit dhe mbikëqyrësi i KQZ-së, nëse i pranishëm, është përgjegjës për përmbledhjen dhe saktësinë e*

rezultateve të votimit të marra nga shënimet e vendvotimit të bëra në format e kërkuara dhe e dërgon formën e kompletuar të FPR-së në vendin e caktuar”. Tutje, referuar Doracakut të Procedurave të Votimit dhe Numërimit (tutje: Doracaku), i miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), përveç që është përcaktuar mënyra e numërimit të votave të kandidatëve, janë përcaktuar edhe përgjegjësit e kryesuesit.

Kështu, në pjesën e 6, të këtij Doracaku (faqe 50 e tutje), “Numërimi i Votave të Kandidatëve”, Hapi 1, mes tjerave parasheh :

- a. Kryesuesi cakton dy (2) anëtarë si LEXUES dhe dy (2) si REGJISTRUES (shkruajnë votat në FLLK);
- b. Votat do të lexohen nga një 1 Lexues, ndërsa 2 Regjistruer do të shkruajnë votat në FLLK. c. Pas përfundimit të dengut (25) Kryesuesi krahason a përputhën votat e kandidatëve në dy FLLK. d. Nëse gjen mospërputhje në fletëvotime, dengu me 25 fletëvotime delegohet dhe lexohen nga Lexuesi 2.

Hapi 2, mes tjerave, parasheh:

- a. Kryesuesi kontrollon a përputhën votat e kandidatëve të shkruara në dy FLLK e regjistruer.

Ndërsa Hapi 3, në vazhdim, mes tjerave, parasheh:

- a. Kryesuesi mbledh votat për secilin kandidat dhe shumën totale e shkruan në Formular të Rezultateve të Kandidatëve (FRK).

Në këtë drejtim, referuar obligimeve të përcaktuara për kryesuesin, Gjykata në rastin konkret ka vlerësuar se dhe komisionerët-anëtarët tjerë të Këshillit të vendvotimit deleguar nga subjektet e ndryshme politike, gjatë procesit të numërimit të votave të kandidatëve nuk kanë kontestuar ndonjë parregullsi dhe të gjithë kanë nënshkruar formularin përfundimtar për rezultatet e votimit dhe si rrjedhojë kësaj prokuroria e shtetit në rastin konkret, përveç përshkrimit faktik të dispozitivit nuk ka mundur të sigurojë fakte juridike relevante përmes të cilave arrihet të vërtetohet dashja e të akuzuarit për të falsifikuar apo për të mos shënuar në mënyrë të saktë rezultatet e votimit.

Kjo vërteton faktin dhe më tepër se, gjatë procesit të numërimit të fletëvotimeve për subjektet politike dhe numërimit të votave të kandidatëve, sipas nenit 102 par.2 të Ligjit për zgjedhjet si dhe doracakut përkatës theksuar më lartë, në pjesën e 6-Hapat, përcakton në mënyrë të qartë se, Kryesuesi i vendvotimit në rastin konkret i akuzuari, përmbledhjen e rezultateve të votimit e kishte marrë nga shënimet e dy (2) anëtarëve si lexues dhe dy (2) anëtarëve tjerë si regjistruer, e më pas kontrollon a



përputhën votat e kandidatëve të shkruara në dy FLLK e regjistruar, pastaj mbledh votat për secilin kandidat dhe shumën totale e shkruan në Formular të Rezultateve të Kandidatëve (FRK).

Pra, si përfundim, Gjykata vlerëson se nuk ka qenë obligim i kryesuesit që të numëroj votat e kandidatëve, sepse edhe ashtu, ai e kishte të pamundur që t'i kontrollonte secilën votë për secilin kandidatë, por detyra e tij kryesore ishte që t'i krahasoj 2 FLK, e një subjekti politik mes veti, dhe nëse ka mospërputhje atëherë të urdhërojë një numërim të ri.

Gjykata, rithekson edhe njëherë se, siç është konstatuar më lartë, është fakt i pakontestueshëm që kishte mospërputhje të rezultateve të kandidatëve, në këtë vendvotim, ashtu që në tërësi rezultoi 119 vota të shtuara për kandidatët e subjekteve të ndryshme politike, ndërsa 12 vota të hequra për kandidatët e subjekteve të ndryshme politike, në total prej 131 votave të pasakta. Por, nga ka rrjedhë kjo pasaktësi, respektivisht se në cilën fazë janë hequr apo shtuar, Gjykata nuk ka arrit ta vërtetojë. Megjithatë, bazuar në aktakuzën e ngritur, Gjykata ka qenë e obliguar të vërtetojë vetëm faktin nëse i akuzuari ka ndërmarrë një veprim të tillë, respektivisht nëse kjo pasaktësi në vota rrjedh nga veprimet apo mosveprimet e të akuzuarit, si kryesues i vendvotimit.

Prandaj, për arsyet që janë dhënë më lartë, Gjykata nuk ka arrit ta vërtetojë se i akuzuari si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të tij, ka ardhur deri te kjo mospërputhje e votave të kandidatëve. Sa i përket, pretendimit të prokurorit, që kryesuesi i KVV, bazuar në nenin 102, par. 2 të Ligjit për Zgjedhjet, ka qenë i obliguar për gjithë rregullsinë e procesit të zgjedhjeve, Gjykata konstaton se është fakt se kryesuesi është përgjegjës për përmbledhjen dhe saktësinë e rezultateve të votimit të marra nga shënimet e vendvotimit të bëra në format e kërkuara. Pra, kryesuesi ka qenë i obliguar t'i përmbahet rregullave dhe standardeve të vendosura nga KQZ-ja, dhe siç ka arsyetuar më lartë Gjykata, i akuzuari si kryesues në tërësi i është përmbajtur rregullave dhe udhëzimeve, ashtu që FRK e kishte plotësuar sipas formës së kërkuar nga par. 2, i nenit 102 të këtij Ligji, duke i bartur rezultatet nga FLK-të e secilit subjekt në FRK. Pra, plotësimin e FRK-së e kishte bërë sipas shënimeve në vendvotim, ashtu siç kërkon kjo dispozitë.

- Për më tepër, duke qenë se vepra penale për të cilën akuzohet i akuzuari, duhet të plotësohet kushti themelor “**dashja**” dhe veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është shtimi, heqja apo fshirja e votave apo nënshkrimeve me qëllim të falsifikimit të rezultateve të zgjedhjeve apo votimeve, regjistrimi në mënyrë të pasaktë i votës apo rezultateve të zgjedhjeve....., në rastin konkret Gjykata vlerëson se nga të gjitha provat e administruara në këtë çështje penale por dhe nga dëgjimi i dëshmitarit, si dhe nga paraqitja e mbrojtjes së të akuzuarit, konstatoi se në veprimet e të akuzuarit nuk është vërtetuar dashja

dhe nga kjo vjen në përfundim se nuk janë përmbushur elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i njëjti.

- Në dispozitën ligjore nga neni 21 të KPRK-së është përcaktuar se :“*Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj*”, ndërsa në par.3 të kësaj dispozitë ligjore është përcaktuar se: “*Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj*”.

Mbi bazën e këtyre, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që nuk është vërtetuar se deri të vepra penale-Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së ka ardhë si pasojë e veprimeve inkriminuese me dashje të të akuzuarit si dhe meqë nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, Gjykata në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 363 par.1, nënpar.1.3 të KPP-së, e ka liruar të akuzuarin nga akuza.

- Gjykata, rikujton parimin kryesor të procedurës penale ”In dubio pro reo”, paraparë në nenin 3, par. 2, të KPP-së, i cili përcakton: “mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarit dhe të drejtave të tij”. Prandaj, duke qenë se Gjykata nuk ka arritur ta vërtetojë përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer këtë veprë penale, atëherë në bazë të kësaj, e ka liruar nga akuza.

#### **- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike –**

- Në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi që shpenzimet e procedurës penale të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës.

Neni 453 par.1 të KPP-së, përcakton se : “*Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykimi me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, Gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449, paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të akuzuarit dhe kompensimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore...*”.

- Sa i përket kërkesës pasurore juridike, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që palë të dëmtuar nuk kishte.

- Gjykata, bazuar në të lartcekurat, e në mbështetje të nenit 363, paragrafi 1, nën-paragrafi,1.3, nenit 453 paragrafi 1, të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti për Krime të Rënda**

**PKR.nr.5/2022, datë 22.04.2024.**

**Zyrtari ligjor**

**Bardh Sylejmani**

**Kryetari i trupit gjykues - Gjyqtari**

**Fatos Sejdijaj**

---

**- KËSHILLË JURIDIKE :** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.